



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2018:071850
Datë: 29.10.2019
Numri i dokumentit: 00611130

P.nr. 01/2019

NE EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtares Emin Salihu, me Ref.i Lartë Naim Keka, në lëndën penale kundër të akuzuarit nga Gjilani, Rr."I", Nr. 49, për shkak të veprës penale Ndotje, degradimi ose shkatërrimi i mjesdit nga neni 347 paragrafi 1 të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.2029/2018, të datës 21.12.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar për vlersimin e pranimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë me datë: 21.10.2019, në prezencën e prokurorit të shtetit Halim Borovci, Avokatit mbrojtës dhe të akuzuarit, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri që konsidero pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga babai [REDAKTUE] dhe eëma [REDAKTUE] mbiemri i vajzërisë [REDAKTUE], i lindur më 15.12.1969, në Fsh. [REDAKTUE] Komuna e Kamenicës, me vendbanim në [REDAKTUE] në Rr. [REDAKTUE], ka të kryer Fakultetin e Bujqësisë, i martuar, baba i tre fëmijëve, pronar i kompanisë "KOFIX" në Fsh. [REDAKTUE] i gjendjes së mesme ekonomike, Shqipëtar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa gjykuar më parë dhe nuk din se a udhëhiqet procedur tjetër penale ndaj tijë.

Është faktor

Sepse, më datë 05.12.2018, në Fsh.K. [REDAKTUE] K.Novobërdë, i pandehuri si pronar i kompanisë "KOFIX" SHPK, është hasur duke ushtruar aktivitet të jashtëligjeshem minerarë, në seperimin e resurseve të shkëmbit të fortë, pa u pajisë me leje të aktivitetit të veçantë.

Me çka ka kryer veprën penale, Ndotje, degradimi ose shkatërrimi i mjesdit nga neni 347 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar, në bazë të nenit 4, 41, 43,46 të KPRK-ës duke u bazuar në nenin 233 dhe nenin 365 të KPPRK-së, të pandehurin e

E GjYKO N

Me dënim me gjobë në shumën prej 600 euro(gjashtëqindë), i cili dënim duhet paguar në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundrën dënim me gjobë do të revokohet dhe do ti zëvendësohet me dënim me burgim.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguan dënimin e shqiptuar me gjobë, gjykata të njëtin do ta zëvendësoj dënimin me gjobë me burg duke llogaritur 20€ për një ditë burgu.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcnim të përmbarimit të dhunshëm.

Në pajtim të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 i Ligjit për kompenzimin e viktimate të krimít, obligohet i akuzuari që të paguaj taksë rë shumën prej 30 euro në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Ndërsa i démtuari Përfaqësuesi i Ministrisë për Miniera dhe minerale në Prishtinë për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës.

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur akuzën PP.II.nr.2029/2018 të datës 21.12.2018, kundër të akuzuarit I. , nga , me vendbanim në Rr. "Lerhim Fazani", për shkak të veprës penale Ndotje, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 paragrafi 1 të KPRK-së.

Pas ngritisës së aktakuzës palët me dat. 29.08.2019, kanë arritur marveshje për pranimin e fajsisë e cila marveshje është deponuar në gjykatë me dat. 09.09.2019 e lidhur mes Prokurorisë Themelore në Gjilan,-Departamenti i përgjithshëm, në njëren anë, të akuzuarit , si dhe mbrojtësit të të akuzuarit , në anën tjeter. Sipas kësaj marrveshje gjykatës i është rekomanduar qe ndaj të akuzuarit , për shkak të veprës penale të cekur më lartë ti shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej 600 € euro(gjashtëqindë). i cili dënim duhet paguar në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundrën dënim me gjobë do të revokohet dhe do ti zëvendësohet me dënim me burgim.

Prokurori i shtetit Halim Borovci deklaron: Me kërkesën e avokatit mbrojtës Svdgil Robelli me Prokurorin e Shtetit në Gjilan janë zhvilluar procedurat alternative të parapara me kodin e Procedurës Penale, rrespikтивisht negocimi mbi pranimin e fajesisë e me çka është arritur kjo marrëveshje në mes të prokurorisë së shtetit në Gjilan, të pandehurit , në prezencën e A..Svdgil Robelli, me çka i pandehuri e ka pranuar veprën penale në mënyrë vullnetare dhe pa presion ashtu siç parashihet në dispozitivin e Aktakuzës si dhe

janë marrë vesh edhe për dënimin i cili është specifikuar edhe me marrëveshje. Andaj kërkoj nga gjykata që të pranoj marrëveshjen si të tillë.

Mbrojtësi i të akuzuarit *Kamiz Thaqi* deklaron: Pas konsultimit paraprak me të akuzuarin me kërkesë i jemi drejtuar Prokurorisë së shtetit për arritjen e marveshjes për pranimin e fajsisë dhe kështu kemi arritur marrëveshje që të akuzuarit ti shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej 600€ euro(gjashtëqindë), i cili dënim duhet paguar në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundrtën dënim me gjobë do të revokohet dhe do ti zëvendësohet me dënim me burgim, dhe se kjo marrëveshje për pranimin e fajsisë është bërë nga vullneti i lirë dhe pa kurfarë presioni.

I akuzuari *Kamiz Thaqi* deklaroj se : Pajtohem me deklaratën e mbrojtësit tim me marveshjen e arritur në mes të prokurorisë së shtetit dhe mbrojtësit tim, pasi që është e vërtet e gjithë ajo e cila është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, pendohem për këtë vepër penale dhe i premtoj gjykatës që kjo do të jetë hera e parë që do të ndeshem me ligjin.

2. Vlerësimi i marrveshjes për pranimin e fajsisë

Në shqyrtimin gjyqësor për vlersimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë të mbajtur me datë 21.10.2019, gjyqtarja e vetëme pas dëgjimit të palëve dhe ate Prokurorit të Shtetit, mbrojtësit i të akuzuarit dhe i akuzuari e ka pranuar marrveshjen për pranimin e fajsisë, nga se ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari *Kamiz Thaqi*, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pas konsultimit me mbrojtësin e tijë, se i akuzuari nuk ka qenë të shtrënguar që ta pranojn fajësin, dhe se pranimi i fajit ka mbështetje në faktet që i përmban aktakuza dhe se nuk egziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 253 par.1 e 2 të KPPRK-ës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lart gjyqtari ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se i akuzuari *Kamiz Thaqi* ka kryer veprën penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 paragrafi 1 të KPRK-ës, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjyqtarëja pas dëgjimit të palëve lidhur me dënimin, e shpalli fajtor të akuzuarin *Kamiz Thaqi* se e ka kryer veprën penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 paragrafi 1 të KPRK-ës, nga se në veprimet e tije manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtat është penalisht përgjegjës.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit, i ka vlersuar se duhet aprovohet rekomandimi i paraqitur në marveshjet për pranimin e fajsisë që ndaj të akuzuarit ~~Naim Keka~~, të i shqiptohet denim me gjobë në shumën prej 600 € euro(gjashtëqindë), i cili dënim duhet paguar në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundertën dënim me gjobë do të revokohet dhe do ti zëvendësohet me dënim me burgim.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata mori për bazë të gjitha rrethanat që ndikojn në lartësinë e dënimit të parapara me nenin 75 parag.1 të KPRK-ës. Kështu si rrethanë lehtësuese mori faktin se ka arritur marvëshjen me Prokurorin e shtetit për pranimin e fajsisë, pra ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit, ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërin shoqërore të kësaj vepëres penale dhe pasojen e shkaktuar nga kjo vepër penale, andaj gjykata konsideron se edhe me një denim të tillë, do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu për të akuzuarin sikur edhe te personat tjerë do të ndikoj pozitivisht në parandalimin që në të ardhmen të mos kryejnë vepra tjera penale.

Gjykata konform nenit 463 parag. të KPRK-së të dëmtuarin, për realizimin e kërkesës pasuror-juridik, e udhëzon në kontest civil.

Në pajtim të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 i Ligjit për kompenzimin e viktimate të krimtit, obligohet i akuzuarii që për programin për kompenzimin e viktimate të paguaj taksë në shumën prej 30 euro në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 450 të KPK-ës.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitivë të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË NOVOBËDË


*Departamenti Përgjithshëm
P.nr.01/2019, më 21.10.2019.*

Gjyqtaria

Ref.i Lartë
Naim Keka

Emine Salihu

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njejtët, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.



P..nr.34/16

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Dega ne Novoberd, Deprtamenti i per gjithshem ,permes gjyqtares Emine Salihu me pjesëmarrjen e bashkepunetorit profesional Sulejman Rexhepi ,ne qeshtjen penale ndaj te pandehuve , nga fsh. B. K, Novoberd dhe Grisha Gjilani nga fsh. B. K e Novoberdes,, për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 285 par. 2 lidhur me nenin 23 te KPK-se, sipas aktakuzës te ish Prokurorise komunale , tani Prokuroria Themelore ne Gjilan –Departamenti i per gjithshem , PP.nr.2629/12 të dt. 12.12.2012, sipas detyres zyrtare me dt 08.08.2019,mori dhe publikisht shpalli kete,

A KTGJYKIM

I Pandehuri Grisha Gjilani nga fsh. B. K, Novoberdes

Ndaj te pandehurit , ne konform te nenit 363 par. 1 pika 1.3 te KPPRK-se.

REFUZOHER AKUZA

Se me date 28.11.2012 , rreth ores 15 , ne teritorin e fsh . B. K, Novoberde ,te vendi i quajtur „F. ” , i pandehuri me qellim vjedhje dhe shitje ne pyllin e prones private dhe shtetore , me sharre motorike ka prere gjithsejt 98 trungje dru bungu , me diameter prej 10-22 cm , me lartesi 5-9 si dhe me vellim te per gjirhshem prej 8, 11 kub,duke e demtuar ekonomine e pyjeve me vlore prej 730,00 E

Me çka kishte per te kryer vepren penale vjedhje pylli nga neni 285 paragarafi 2 te KPKse

Me qe ka te beje me parashkrimin absolut te vepres penale .

E demtuara – perfaqsuesi i APK-se , zyra ne Gjilan per realizimin e kerkeses pasurore juridike udhzohet ne kontest te rregullt civil .

Shpanzimet e procedures penale paguhën nga mjetet buxhetore te kesaj gjykate

Me aktgjykin Pnr. 18/2013 te dates 23.05.2016 me konform te nenit 363 parag.1 nen nen parg..1.1 te Kodit te procedures penale te Republikës se Kosovës, ndaj te pandehurit eshte REFUZUAR AKUZA me qe Prokurori i shtetit eshte terhequr nga akuza ne shqyrtimin gjyqesor .

Arsyetim

Prokuroria Komunale , tani Prokuroria Themelore ne Gjilan , Departamenti i Pergjithshem me date 12.12.2012, ka ngritur Aktakuzen PP.Nr.2629/2012 ndaj te pandehurve : _____ nga fsh. _____ dhe _____ nga fsh. M K, Novoberd , per shkak te vepres penale Vjedhje pylli nga nenin 285 parag 2 lidhur me nenin 23 te KPRKS-se.

Gjykata gjate shqyrtimit te aktakuzes me nr dhe date si me larte si dhe shkresave te tjera ne lende me konform te nenit 3 te KPRK-se , ka bere rikualifikimin e vepres penale vjedhje pylli nga nenin 285 paragrafi 2 te KPK, per te cilen veper penale denimi ashte i parapare me gjobe ose me burgim prej 6 muajve deri ne 5 vite , ne nenin 358 paragrafi 2 te KPRKse , per te cilen parashihet denimi me gjobe dhe me burgim prej tre muajve deri ne 3 vjet , me qe ndaj kryesit zbatohet ligji qe eshte me i favorshem ,me qe ne rastin konkret ligji ne fuqi ka ndryshuar para shqiptimit te vendimit te foremes se prere si dispozite me e favorshme sa i perkthet lartesise se denimit , dhe ne kete kontest duke u bazuar ne kohen e kyerjes se vepres penale konstatoj se .meqense nga koha e kyerjes se vepres penale perkatsisht nga data 28.11.2012 e gjere me tani kan kaluar me shum se 6 vite , kemi te bejme me vjetersim absolut te vepres penale , ne kuptim te nenit 107 parg.8 te KPRK-se, andaj edhe per kete veper penale nuk mund te vazhdohet ma ndjekja penale .

Gjyqtarja e vetme gjykuese , duke u bazuar ne nenin 463 parg. 3 te KPPK, ka vendosur qe te demtuaren APK-zyra ne Gjilan , per realizimin e kerkeses pasurore juridike ta udhezoj ne kontest te rregullt.civil .

Duke patur parasysh vendimin perfundimtar per qeshtjen penale ne fjale ndaj te pandehurit te lartepermendur , gjykta mori vendim qe shpenzimet e procedures penale te paguhen nga mjetet buxhetore e ne pajtim me nenin 454 paragrafi 1 te KPPRK-se .

Duke u bazuar ne keto qe u ceken me larte , e ne baze te nenit 363 parag.1 nenparag. 1.3 te KPP se eshte vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjikimi .

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, dega ne Novoberd

Dekanamenti I Pergjithshem

P.nr 34/2016

Më 08.08.2019

Bashkepunetori Profesional

Sulejman Rexhepi

S. Rexhepi

*Gjyqtarja
Emine Salihu, d.v.*

E. Salihu

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.